



Pranimi / Donesat Prilazja / Prilazja Receipts / Receipts	04-03	2021	1	viti god year
Organ / Institucia Organ / Institucia Org / Inst	In Prok In Prok In Prok	Shlyerja Prilazja Appendix	Sasia Kolicina Quantity	
SKM/SHK	980/2021		113	



Republika e Kosovës  
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.38/2021

Këshilli i Pavarur Mbiqëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës – Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosijen e Ankesave, në përbërje nga: Arben Mehmeti-kryetar, Ardita Haxhnikaj-Demi dhe Eshref Shabani, anëtarë, si dhe Sabile Avdyli Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.38/2021 të datës 29.01.2021, të parashtruar nga \_\_\_\_\_ të cilin me autorizim e përfaqëson avokati \_\_\_\_\_ me adresë banimin Rr.“Afrim Zhitia”, pn, Komuna e Mitrovicës, kundër organit të punësimit Universiteti i Prishtinës “Hasan Prishtina”, në çështjen juridike “kompensim material”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.8 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, si dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosijes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbiqëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur më datën 04.03.2021, mori këtë:

V E N D I M

Këshilli i Pavarur Mbiqëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, shpallet jo kompetent për të vendosur për ankesën me numër A.nr.38/2021 të datës 29.01.2021 të parashtruar nga ankuesi

A r s y e t i m

Ankuesit \_\_\_\_\_ i punësuar në Universitetin e Prishtinës “Hasan Prishtina” sipas Akt emërimit të datës 23.04.2012 në pozitën Shefi Financave në Fakultetin e Ndërtimitarisë dhe Arkitekturës, përmes përfaqësuesit të autorizuar avokatit \_\_\_\_\_ ka parashtruar ankesë me numër protokollit 354/2021 të regjistruar me numër A.nr.38/2021 në Këshillin e Pavarur Mbiqëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimin ankimor për njohjen e të drejtës për kompensimin e shtesave për punën e kryer nga data 01.10.2019 deri më datën 30.09.2020 i cili është angazhuar për kryerjen e detyrave të buxhetit dhe financave edhe të Fakultetit të Arkitekturës.

Me datën 09.11.2020 ankuesi ka parashtruar kërkesë me nr.2/265 të Këshillit Drejtues të Universitetit të Prishtinës “Hasan Prishtina” për kompensim retroaktiv prej 30% të punës shtesë nga data 01.10.2019 deri më datën 30.09.2020 në Fakultetin e Arkitekturës. Këshilli Drejtues i Universitetit të Prishtinës “Hasan Prishtina” me vendimin e datës 11.12.2020 me numër protokollit 3/874 ka refuzuar kërkesën e ankuesit.

Ankuesi i pakënaqur me vendimin \_\_\_\_\_ me vendimin e datës 11.12.2020 me numër protokollit 3/874 të Këshillit Drejtues i Universitetit të Prishtinës “Hasan Prishtina” me datën 11.12.2020 ka parashtruar ankesë në Komisionin për Ankesa dhe Parashtrësia të Këshillit Drejtues të Universitetit të Prishtinës. Komisioni për Ankesa dhe Parashtrësia i Këshillit Drejtues të Universitetit të Prishtinës me datën 30.12.2020 me vendimin nr.4/22 refuzon ankesën e ankuesit.

I pakënaqur me vendimin nr.4/22 të datës 30.09.2020 të Komisionit për Ankesa dhe Parashtrësia të Këshillit Drejtues të Universitetit të Prishtinës, ankuesi përmes përfaqësuesit të autorizuar avokatit \_\_\_\_\_ ka parashtruar ankesë me numër \_\_\_\_\_

protokolli 354/2021 të regjistruar me numër A.nr.38/2021 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 05.02.2021, ankesën e ankuesit e ka proceduar për përgjigje në ankesë tek Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina". Me datën 13.02.2021 Menaxheri i Personelit i Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina" përmes e-mailit zyrtar ka njoftuar se: bazuar në Ligjin Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë nëpunësitë e administratës në Universitetin e Prishtinës nuk i përkasin kategorisë së shërbyesve civil.

**Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave ka administruar këto prova:** Ankesën me numër protokoli 354/2020 të datës 29.01.2021 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Autorizimi i datës 26.01.2021 i avokatit Kërkesë e datës 09.11.2020 me numër protokoli 2/265; ; Vendimin e datës 11.12.2020 me numër protokoli 3/874 të Këshillit Drejtues të Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina"; Ankesa e datës 11.12.2020 e parashtruar në Komisionin për ankesa dhe parashtrësia i Këshillit Drejtues të Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina"; shkresat e bashkangjitura në kërkesën e datës 11.12.2020; njoftim i datës 30.12.2020 lidhur me ankesën e datës 11.12.2020 me numër protokoli 2/766; Vendim i datës 06.12.2019; vendim i datës 10.10.2019; E-mail zyrtar i datës 13.02.2021 dhe Akt emërimi i datës 23.04.2012.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pas shqyrtimit të shkresave të lëndës ka konstatuar se Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës nuk është kompetent për të vendosur lidhur me ankesën e parashtruar nga ankuesi **sepse:**

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pasi ka shqyrtuar dëshmitë e ofruara nga organi i punësimit –Universiteti i Prishtinës, ka konstatuar se: sipas Ligjit, Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë përkatësisht nenit 2 paragrafit 4 përcaktohet se: **"4. Nëpunësi i Shërbimit Publik - është personeli i nivelit të lartë drejtues, drejtues, profesional dhe i shërbimeve të brendshme në administratën e shërbimeve publike, pjesë e administratës shtetërore apo në administratën e shërbimeve publike, pjesë e një komune të cilët ofrojnë shërbime publike të drejtpërdrejta për qytetarët në fushën e arsimit, shëndetësisë, kulturës, artit si dhe shërbime tjera të ngjashme publike"**, dhe si rrjedhojë ka konstatuar se zyrtarët publik të nivelit të lartë drejtues, profesional dhe shërbimeve të brendshme në kuadër të Institucioneve Publike të Arsimit të Lartë në Kosovë, respektivisht në Universitetet Publike, kanë statusin e nëpunësit të shërbimit publik. Andaj, duke marrë parasysh se ankuesit tanimë me Ligjin Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë i përkasin kategorisë së nëpunësve të **Shërbimit Publik**, Kolegji vlerëson se Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës nuk është kompetent për të vendosur për nëpunësit me status të shërbimit publik.

Bazuar në nenin 6 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Këshilli është kompetent për të vendosur vetëm për nëpunësit civil dhe kandidatët për praninë në Shërbimin civil, siç është përcaktuar në nenin 2 paragrafi 2 nën paragrafi 2.1 dhe paragrafi 3 si dhe nenin 4 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, pas konstatimit se Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës nuk është kompetent për të vendosur për ankesën e ankuesve, udhëzoi palët për ushtrimin e mjeteve juridike bazuar në dispozitat e Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, përkatësisht nenin 74 si dhe nenin 24 paragrafi 4 ku përcaktohet se: **"Nëpunësi i Shërbimit Publik dhe nëpunësi administrativ dhe mbështetës kanë të drejtë të ankohen të punëdhënësi dhe më pas mund të fillojë kontest administrativ në gjykatën kompetente"**.

Bazuar në këto rrethana, Kolegji për shqyrtimin e ankesës, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në kompetencën e Këshillit, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

**Këshillë juridike:** Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës  
Lënda me numër A.nr.38/2021, datë 04.03.2021

Sabile Avdyli  
*Sabile Avdyli*  
Procesmbajtëse



**Vendimi i dërgohet:**

- Përfaqësuesit të autorizuar të ankuesit, avokatit
- Sekretarit të Përgjithshëm të Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina".
- Udhëheqësit të Personelit në Universitetin e Prishtinës "Hasan Prishtina".
- Arkivit të KPMSHCK-së.